



Vendbanimet joformale

Hyrje

Në këtë fletushkë kemi trajtuar çështjen e vendbanimeve joformale anekënd Kosovës. Ne promovojmë "të drejtën në qytet", që nënkupton të drejtën e secilit person në qytet apo komunitet për të qenë pjesëtar i barabartë i komunitetit. Si pjesëtar i barabartë, secili banor i qytetit do të duhej të gëzojë realizimin e të drejtave të tij/saj për standard adekuat të jetës dhe qasje në shërbime në nivel të njëjtë.¹

Në vitin 2005, Kosova ka nënshkruar Deklaratën e Vjenës për Vendbanime Joformale, që kërkon si parandalimin e vendbanimeve të reja joformale, ashtu edhe rregullimin e atyre ekzistuese. Parandalimi dhe rregullimi i vendbanimeve joformale është përfshirë edhe në Planin për Zbatimin e Standardeve për Kosovën (PZSK), si dhe në dokumentin pasues – Planin e Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE). Çështja e vendbanimeve joformale përbën një pjesë të rëndësishme të përparpimit të Kosovës në përmbushjen e Caqeve Zhvillimore të Mileniumit. Në këtë drejtim, rëndësi kanë edhe masat speciale për trajtimin e nevojave të romëve/ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës, të cilët jetojnë në vendbanime joformale (dhe që në disa raste janë të zhvendosur si pasojë e konfliktit).

Kjo fletushkë është rezultat i aktiviteteve të përbashkëta të kryera nga Grupi Punues për Vendbanime Joformale, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(MMPH), Asociacionit të Komunave të Kosovës(AKK), OSBE dhe MUSPP/UN-HABITAT.

¹Shih 'Kartën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Qytet' dhe 'Kartën Botërore mbi të Drejtat në Qytet'.

Aty jetojnë njerëzit



Çfarë punësh janë duke u realizuar?

© **Shtator 2007:** Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka themeluar Grupin Punues për Vendbanime Joformale për të inicuar një proces të gjerë dhe të integruar diskutimesh, që do të shpiente drejt formulimit të 'Strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për vendbanime joformale'.

© **Prill dhe Qershor 2007:** Janë mbajtur punëtori të bashkëpunimit në Gjakovë dhe në Pejë, ku kanë marrë pjesë të gjitha palët relevante. Punëtoritë kanë përfshirë vizita në terren të vendbanimeve joformale si dhe prezantimin e veprimeve të ndërmarra dhe rekomandimeve të grupeve punuese. Këto rekomandime kanë përfshirë nevojën për debat interaktiv dhe për zhvillim strategjik dhe nevojën për vetorganizimin e komunave përkatëse, duke përfshirë mënyrat e ndryshme si mund të kontribuojnë ato në zhvillimin vetanak, nëpërmjet qendrave të komunitetit, krijimit të të ardhurave dhe mundësive të ndryshme të financimit.

© **Nëntor 2006:** 'Punëtorja për zhvillimin urban dhe rregullimin e vendbanimeve joformale në Kosovë' që kanë mbajtur MuSPP/UN-HABITAT-i, MMPH-ja dhe OSBE-ja. Të gjitha komunat, ministritë përkatëse dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të sektorit privat, kanë shqyrtuar gjendjen e bashkëpunimit me ekspertë të njohur ndërkombëtarisht dhe i kanë përgatitur rekomandimet.

© **Përpilimi i planeve të zhvillimit urban:** Përveç nismave të udhëhequra nga komunitetet, edhe qeveria luan një rol qenësor. Vendbanimet joformale duhet të rregullohen me anë të mekanizmave ekzistues të planifikimit:

- © Planeve Zhvillimore Komunale (PZHK)
- © Planeve Zhvillimore Urbane (PZHU)
- © Planeve Rregulluese Urbane (PRrU)

Planet e pjesërishme dhe të fragmentuara nuk kanë perspektiva afatgjata dhe rritja e popullsisë nënkupton shti

min e nevojës për t'i kuptuar karakteristikat e vendbanimeve individuale joformale. Punëtoritë e mbajtura në terren kanë treguar se ka praktika të mira në Kosovë. Ato përfshijnë:

© Maj 2007, Kuvendi Komunal i Pejës ka miratuar Planin Zhvillimore Komunal dhe Planin Zhvillimor Urban për 2006 – 2025. Kuvendi Komunal i ka deklaruar këto plane si vitale për zhvillim ekonomik dhe për mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore - historike të komunës. Vendbanimet joformale kudo në komunën e Pejës tash janë të përfshira në PZHU dhe PZHK..

© Në Zatra, të komunës së Pejës, OJQ-ja Syri i Vizionit, kreu profilizimin e komunitetit në kuadër të një pilot projekti për planifikim urban në partneritet me Kuvendin e Komunës, MuSPP/UN-HABITAT-in dhe agjencitë tjera.

© Në Brekoc të komunës së Gjakovës, Projekti për Plan Rregullues është financuar nga Fondi për Zhvillimin e Komuniteteve (Community Development Fund - CDF). Plani rregullues është përgatitur me konsultimin e një kompanie dhe kësajohi është ndërtuar një qendër e komunitetit. Sistemi i kanalizimit në këtë vendbanim është bërë në koordinim me planin rregullues që ka propozuar ekipi i MuSPP/UN-HABITAT-it.

© MMPH-ja ka krijuar udhëzime dhe ka ofruar trajnim për të gjitha komunat nëpërmjet CDF-së

© Ndryshimi i Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor


Këto qasje të ndryshme tregojnë qasjet e vendimarrjes në vija vertikale, nga lartë-poshtë, me ç'rast planet rregulluese pasojnë PZHK-në, si dhe ato që shkojnë nga poshtë-lartë, me ç'rast planet rregulluese nxisin zhvillimin e PZHK-së.



Kontakti

MMPH:	Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divisionit të Planifikimit Komunal	suzana.goranci@ks-gov.net
AKK:	Sazan Ibrahimimi, Drejtor ekzekutiv	sazanibrahimi@komunat.net
UN-HABITAT:	Krystyna Galezia, Koordinatorë për shoqëri civile, qështje gjinore dhe ngritje të kapaciteteve	krystyna.galezia@unhabitat-kosovo.org
OSBE:	Marie-Astrid Huemer, Këshilltare e lartë e të drejtave të njeriut	marie-astrid.huemer@osce.org

Përmbajtja kryesore e kësaj fletushke është rezultat i aktiviteteve të përbashkëta të ndërmarra nga Grupi Punues për vendbanimet joformale i përbërë nga konsultantë dhe përfaqësues të MMPH-së, AKK-së, MuSPP/ UN-HABITAT-it dhe OSBE-së.

Programi për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor në Kosovë i UN-HABITAT-it financohet nga  Sida
Vizitoni faqen tonë: www.unhabitat-kosovo.org

Bashkë Bëjmë Qytete më të Mira



Pse duhet vepruar në rastin e vendbanimeve joformale?

Trajtimi i rasteve të vendbanimeve joformale të deprivuara paraqet pjesë kritike të procesit të zgjidhjes së çështjes së varfërisë dhe të përmirësimit të qeverisjes në Kosovë. Banorët e vendbanimeve joformale zakonisht janë të varfër dhe pjesëtarë të pakicave etnike dhe jetojnë pa qasje adekuate në shërbime.

Zakonisht nuk ka furnizim me ujë, kanalizim, asfaltim të rrugëve, ndriçim dhe furnizim me energji elektrike, transport publik dhe mbledhje të mbeturinave, gjë që shkakton rreziqe për shëndet dhe siguri.

Banorët kanë gjasa të jenë të diskriminuar, mundësitë ekonomike mund të jenë të kufizuara dhe familjet që nuk kanë qëndrim të sigurtë mund të gjinden në situata ku rrezikojnë të humbin shtëpitë e tyre. Trajtimi i të gjitha rasteve të vendbanimeve joformale (të varfëra dhe jo të varfëra) është i domosdoshëm për të siguruar një zhvillim më të qëndrueshëm urban në Kosovë.

Çka synojmë të arrijmë nëpërmjet këtij procesi?

Qëllimi i këtyre intervenimeve në të gjitha shkallët/nivelet, do të duhej të jetë :

- rregullimi i vendbanimeve joformale ekzistuese dhe parandalimi i krijimit të vendbanimeve të reja,
- sigurimi i urbanizimit të qëndrueshëm në Kosovë,
- përmirësimi i standardeve të jetës dhe zbutja e varfërisë, dhe
- zhvillimi i politikave të qëndrueshme të tokës, banimit dhe planifikimit hapësinor për Kosovën.

Arritja e këtyre caqeve do të kërkojë angazhimin e të gjitha grupeve relevante të interesit, duke përfshirë qeverinë e Kosovës, komunat dhe banorët e vendbanimeve joformale. Të gjitha vendbanimet joformale duhet të përfshihen në planet zhvillimore komunale dhe në planet zhvillimore urbane dhe duhet investuar për ngritjen e shërbimeve dhe infrastrukturës deri në nivel të standardeve të pjesëve tjera të Kosovës.

Përveç kësaj, zhvillimi i planeve të banimit me çmime të pranueshme dhe zhvillimi ekonomik mund të ndihmojnë në parandalimin e krijimit të vendbanimeve të reja joformale. Banorët kontribuojnë duke paguar tatime dhe faktura të ndryshme dhe duke e respektuar ligjin. Rregulloret e planifikimit duhet të zbatohen nëpërmjet ligjit për të gjithë zhvilluesit/ndërmarrësit e pronave (ndërtimit).

Çka janë vendbanimet joformale?

Vendbanimet joformale janë vendbanimet e njerëzve të cilat nuk iu ofrojnë banorëve mundësinë për realizimin e të drejtave të tyre për të pasur standard të përshtatshëm jetese.

Vendbanimi joformal karakterizohet si :

- ⊗ i paplanifikuar,
- ⊗ me banim joformal apo të pasigurtë,
- ⊗ me pjesëmarrje joadekuate apo mospjesëmarrje në qeveri, gjë që rezulton me mungesën e shërbimeve themelore, mungesën e regjistrimit dhe të infrastrukturës,
- ⊗ vend ku ka mundësi të diskriminimit të banorëve.

Të qenët joformal nuk nënkupton të qenët kalimtar apo të përkohshëm. Disa vendbanime joformale në Kosovë kanë ekzistuar me vite, madje edhe dekada. Ato paraqesin komunitete të njerëzve, të cilët kanë jetuar së bashku dhe kanë ndërtuar atë që kanë me pasuritë, që i kanë pasur në dispozicion, me fare pak, apo edhe pa ndihmë të jashtme. Përveç kësaj, nuk janë të gjitha vendbanimet joformale të varfëra. Ka vendbanime joformale që janë krijuar edhe nëpërmjet spekulimeve rreth tokës dhe nga zhvilluesit/ndërmarrësit e papërgjegjshëm të pronës.

Pse zhvillohen vendbanimet joformale?

Arsyet përfshijnë:

- ⊗ Tokën dhe banim të shtrenjtë për grupe me të ardhura të vogla
- ⊗ Mungesën e planifikimit urban dhe menagjimit të tokës në hap me kohën
- ⊗ Mungesën e politikës për integrim social për grupet me të ardhura të vogla
- ⊗ Migrimin e popullatës dhe rritjen e shpejtë urbane
- ⊗ Mungesën e resurseve të autoriteteve urbane
- ⊗ Nën-ndarjen e papërgjegjshme të tokës nga ana e pronarëve privat
- ⊗ Mungesën e zbatimit të rregullave si pasojë e qeverisë së dobët dhe joefektive

Për zgjidhjen e problemit, nevojiten sikur masat korrigjuese, siç janë rregullimi dhe përmirësimi i infrastrukturës, ashtu edhe ato parandaluese, siç janë politikat për tokë dhe ndërtimin e banimit social.

